



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2301 / Prot
11

Elbasan më 28 /05/2020

VENDIM

Nr. 47 datë 28 /05/2020.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin PRILL 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin PRILL 79 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2309 Prot

Elbasan më 28/05/2020

VENDIM

Nr. 48 datë 28/05/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin PRILL 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **PRILL 2020** gjithsej 122 familje me një fond prej 388.204 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja





698
28.05.2020
SECRETARIA
KESHILLI QARKORIT ELBASAN

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2257 Prot.
11

Elbasan, më 28.05.2020

V E N D I M

Nr. 49 Datë: 28.05.2020

“Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambientit ish-Gjendja Civile Lagja “Aqif Pasha”, P.D.I.U. dega Elbasan nga Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.05.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambientit ish-Gjendja Civile me sipërfaqe 62.2 m², ndodhur në Lagjen “Aqif Pasha”, Z.K 8524, për t’u përdorur si zyra të P.D.I.U dega Elbasan, për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.06.2020 deri më 31.05.2021 (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori pronave), Drejtoria e Përgjithëshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

4.1

KRYETARI
Hektor Çiftja

49





3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2298 Prot.
11

Elbasan, më 28.05.2020

V E N D I M

Nr. 50 Datë: 28.05.2020

“Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshtërim (rinovim kontrate) të ambientit ish-DRSHTRR Lagja “Hekurudha”, U.K.E sh.a. nga Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28.05.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien në përdorim, pa kundërshtërim (rinovim kontrate) të ambientit ish-DRSHTRR me sipërfaqe 209 m² ndërtesë dhe 740 m² truall, ndodhur në Lagjen “Hekurudha”, Z.K. 8523, për t’u përdorur si zyra të U.K.E Sh.A., për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.04.2020 deri më 31.03.2021 (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori pronave), Drejtoria e Përgjithëshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja





121

700
28.05.2020

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2299/11 Prot.

Datë 28 .05. 2020

VENDIM

NR. 57 DATË 28 . 05. 2020

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2020”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 28 .05.2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2020”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI

1. Të miratoje “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2020”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja





20

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN

Nr. 2302 / Prot.

Datë 28.05. 2020

VENDIM

NR. 52 DATE 28.05.2020

MBI

**“SHTESË E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE E SHPENZIMEVE, SI DHE
TRANSFERIM FONDE, NË BUXHETIN E VITIT 2020”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Vendimin e Këshilli Bashkiak Nr.201, datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”, pasi mori në shqyrtim materialet mbi “Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve dhe transferim fonde, në buxhetin e vitit 2020”, të përgatitura nga administrata e Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

- Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020, si më poshtë dhe sipas pasqyrave bashkëlidhur :
 - Të ardhura gjithsej: 42,893,244.42 lekë
 - Shpenzime gjithsej : 42,893,244.42 lekë
- Në buxhetin e vitit 2020, miratuar me vendimin e KB nr.201, datë 24.12.2019, të bëhen transferimet e fondeve me financim nga të ardhurat e vitit 2020, si më poshtë :

Paksime :

Programi	Kapitulli	Artikulli	Shuma /leke	Njesia shpenzuese
01710	5	166	2,500,000	NJ.M.B.S

21

Shtesa :

Programi	Kapitulli	Artikulli	Shuma /leke	Njesia shpenzuese
01110	5	602	1,000,000	Bashkia
03280	5	600	1,500,000	Bashkia (SHMZSH)
		Gjithsej :	2,500,000	

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe njësitë shpenzuese.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajd Gripshi



KRYETAR
Hektor Çiftja

Hektor Çiftja

